



KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 623-21-6247-5-3-6/C340

Emri i Autoritetit Kontraktues: KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: "ANEA" SH.P.K., Avdulla Bugari p.n., Rahovec, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Titulli i Kontratës: RIPARIME NË TRI OBJEKTE SHKOLLORE

Me numër identifikues: 623-21-6247-5-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Riparime në tri objekte shkollore, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: datën e nënshkrimit dhe përfundon për një periudhë prej 20 ditë.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë: Në Komunën e Rahovecit.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **9,060.50 Euro**;

[Nëntë mijë e gjashtëdhjetë Euro e pesëdhjetë Cent]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të punëve.

Shume e sigurisë së ekzekutimit është: **906.05 Euro**, për kohëzgjatjen e periudhës prej: **50 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të kryej ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshterinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshteria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip]³ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.


Për Autoritetin Kontraktues:		Për Kontraktuesin:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Bejtulla Mashuku
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.12.2021	Data:	08.12.2021
Vula:		Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

RIPARIMI I KULMIT NË SHFMU "RILINDJA" ÇIFLLAK

Verejtje: Kontraktori duhet patjetër t'iu referohet Specifikimeve Gjenerale dhe detaleve. Cmimet duhet te përfshijne furnizimin, transportin dhe instalimin/finalizimin e te gjitha materialeve. Kontraktori duhet te dorezoje Deklaratat e Konformitetit per te gjitha materialet e perdorura ne këtë projekt. Për të gjitha punët e ekzekutuara, patjetër duhet të bëhen testet paraprake.

1. PUNËT E RIPARIMIT TË KULMIT					
POS.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.1	Demolimi dhe largimi me kujdes i xhamave të vendosur në kulmin e objektit të Shkollës. Xhamat të cilët demolohen duhet të ngarkohen, transportohen si dhe deponohen në deponi të vjetër. 	m ²	68	10	680.00
1.3	Rregullimi i dëmtimeve të konstrukcionit të kulmit prej profileve të hekurit si dhe pastrimi i konstrukcionit metalik, pastrimi (largimin e ndryshkut) me pajset adekuate me letër gërryese i profileve metalike dhe pjesëve ku do të vendosen Xhamat.	komplet	1	100	100.00
1.4	Furnizimi, transporti dhe ljeraj e konstrukcionit metalik në kulëm me ngjyrë antikoruzive dhe ngjyrë yndyrore dhe atë në dy shtresa.	komplet	1	50	50.00
1.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i xhamave transparent me trashësi 3+3.1 solarë (6mm me folie në mes) në kulmin e objektit të shkollës	m ²	68	40	2,720.00
1.6	Furnizimi transporti dhe vendosja e shtikonit adekuat, xhatë montimit të xhamave në kulëm si dhe gjat gjith skajeve të xhamit	komplet	1	1	1.00
Gjithsej POS 1:					3,551.00
REKAPITULIM					
1	PUNËT E RIPARIMIT TË KULMIT			TOTALI:	€ 3,551.00




Paramasat e kulmit të depos në paralelen e ndarë në Retijë të Poshtme.

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Trarë druri 16cmx14cm -8m	copë	2	15 €	30.00
2	Trarë druri 11cmx9cm -3m	copë	22	10 €	220.00
3	Listela	m	150	1.00 €	150.00
4	Kontar listela	m	70	1.00 €	70.00
5	Drrasa 1.2cm (Patos)	m ²	50	1.00 €	50.00
6	Folje difuzive	Rolne	1	50 €	50.00
7	Tjegulla	copë	600	0.35 €	210.00
8	Kulumar	copë	23	5.00 €	115.00
9	Gozhda	kg	15	1 €	15.00
Gjithsej					910.00



SHML"12MAJI" – RATKOC
Specifikacioni për rregullimin e rrugës dhe hapësirave gjelbëruse
Furnizimi, transporti dhe kryerja e punës

Nr.	Përshkrimi i materilit	Njësia	Sasi	Çmimi	Gjithësej	Specifikacioni
1	Furnizimi me gur të thyer 2mm	kamion	5	100	500	Gur të thyer sepracioni me dimenione 2mm ose sipas nevojës .
2	Furnizimi me dhe cilësor për mbjelljen e barit	kamion	5	80	400	Dheu të jetë ranishtë ose sipas përshatjes
3	Puna me bager për nivelizimin e hapësirave punuse	Orë pune	3	25	75	
4	Pastrimi i hapësirave nga mbetjejt e ngurta	Paushall			0	Largimi i pengesave për rregullimin e rrugës dhe hapësirave gjelbëruse
					Gjithësej	975



SHML"12MAJI" – RATKOC
Specifikacioni për rregullimi i kabineteve me qeramik dhe material përciellës
Furnizimi, transporti dhe kryerja e punës

Nr.	Përshkrimi i materialit	Njësia	Sasi	Çmimi	Gjithësej	Specifikacioni
1	Qeramik	m2	200	8	1600	Qeramika të jetë e porcelanit me dimensione 60x60 gjyë e bardhë
2	Ngjitës/lepak	Thasë	150	5	750	Ngjitës për pllaka qeramike porcelanit gmatfix 25 kg.
3	Fugofil	Kg	25	2.5	62.5	Ngjyra e përshtatshme me qeramiken
4	Kënde plastike	M	30	0.4	12	Kënde për qeramike për mbulimin e hupësirave sipas nevojës
5	Puna e dorës	Metër	200	6	1200	
Gjithësej					3624.5	



REKAPITULLIM I PËRGJITHSHËM		
Nr.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	SHUMA TOTALE
1	RIPARIMI I KULMIT NË SHFMU "RILINDJA" ÇIFLLAK	3,551.00
2	Kulmi të depos në paracelen e ndarë në Retijë të Poshtme	910.00
3	Rregullimin e rrugës dhe hapësirave gjelbëruse SHML"12MAJI" – RATKOC	975.00
4	Rregullimi i kabineteve me qeramik dhe material përciellës SHML"12MAJI" – RATKOC	3,624.50
TOTALI:		9,060.50

Alb

